



KPPP.nr. 336/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës- Ferizaj, rr. “Vëllezërit Gërvalla”, kundër debitorit Komuna e Kamenicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në rr. “Skënderbeu”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020, të Përmbartuesit Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 07.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Kamenicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu - Ferizaj, për pjesën e kamatës ligjore nga dt. 07.08.2020 gjerë në pagesën përfundimtare.

II.MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 3,500.00 (tre mijë e pesëqindë euro).

III.PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Inspektorati i Punës-Ferizaj, ndaj debitorit Komuna e Kamenicës, Drejtoria Komunale e Arsimit sipas urdhrit P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020 të Përmbartuesit Privat Besnik Aliu, për pjesën e kamatës ligjore nga dt. 07.08.2020 gjerë në pagesën përfundimtare.

A r s y e t i m

Kreditori, Inspektorati i Punës – Ferizaj, ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit Komuna e Kamenicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – vendimit nr. 265/20 të dt. 21.05.2020, i formës së prerë dhe i

ekzekutueshëm me datë 07.08.2020, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës së shqiptuar ti paguaj shumën prej 3,500.00 euro.

Përmbaresi Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020, me të cilin është detyruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 3,500.00 euro, me kamatë ligjore nga dt. 07.08.2020, gjerë në pagesën përfundimtare. Realizimi i përmbarimit të bëhet ashtu që të ndalohet qarkullimi i mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BQK ose sekuestrimin e gjësendeve të luajtshme gjerë në bartjen e shumës së cekur në paragrafin 1 të këtij vendimi në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se pranë gjykatës themelore është paraqitur padi për anulimin e vendimit në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore, dhe se i njëjti vendim është nxjerrë me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht nenin 22 par 1 nën par 1.2 të LPA –së, duke shtuar se është në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 dhe 27 të LPP –së. Andaj, i ka propozuar gjykatës që aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të anulohet urdhri përmbarimor dhe të detyrohet kreditori ti mbuloj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se prapësimi është i pabazuar dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të refuzohet. Ka shtuar se inspektorati i punës në bazë të ankesës së palës ka ushtruar vizitë inspektuese te punëdhënësi dhe pas prezantimit të dokumentacionit dhe analizimit të tyre gjeti shkelje ligjore dhe me vendimin nr.18/2020 të dt. 17.01.2020 obligon punëdhënësin të eliminoj parregullsitë ku ndaj këtij vendimi nuk ushtrohet ankesë në organin e shkallës së dytë dhe punëdhënësi nuk zbatoj vendimin e organit të shkallës së parë, andaj i shqiptohet gjobë me vendimin nr. 265/20 dt. 21.05.2020, ndaj të cilit ushtrohet ankesë në organin e shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe me vendimin nr. 387/20 të dt. 07.08.2020 refuzohet si i pa bazuar. Në fund ka theksuar se ngelin pranë propozimit të dhënë me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktvendimin e Inspektoratit të Punës në Ferizaj, nr.265/20 të dt. 21.05.2020, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu vendimi, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret vendimi në fjalë, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi i Inspektoratit të Punës në Ferizaj, nr.265/20 të dt. 21.05.2020 është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 07.08.2020.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”.* Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përbarimore.

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përbarimor P.nr.620/2020 të datës 23.10.2020, të Përbaruesit Privat Besnik Aliu, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përbarimor, pasi që konstatoi se me dokumentin përbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përbarim, debitori është obliguar që në

emër të gjobës ti paguaj kreditorit shumën prej 3,500.00 euro, mirëpo jo edhe kamatën ligjore dhe si i tillë urdhri përmbartimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbartimor, andaj gjykata të njëjtin e shfuqizoi pjesërisht vetëm sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.336/22, datë 07.11.2022

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.